

Puna dhe Pensioni në Gjermani dhe në Kosovë

- ✎ Si ndikon marrëveshja
- ✎ Cilat janë përfitimet që mund të merrni në Gjermani dhe në Kosovë
- ✎ Partnerët tuaj të kontaktit

Të punoni pa kufi

Ju keni punuar tashmë një fare kohe në Kosovë dhe tani dëshironi të ktheheni atje? Ju jeni shtetas i Kosovës dhe punoni tani në Gjermani?

Ndoshta e pyesni veten si puna juaj në vende të ndryshme do të ndikojë në pensionin tuaj të mëvonshëm. Në fund të fundit, Kosova dhe Gjermania kanë sisteme të ndryshme të sigurisë sociale.

Kjo është e vërtetë – sistemet janë të ndryshme. Dhe nuk ka një marrëveshje të veçantë për sigurimet shoqërore midis Gjermanisë dhe Kosovës. Megjithatë, marrëveshja gjermano-jugosllave për sigurimin shoqëror të datës 12 tetor 1968 vazhdon të zbatohet njëanshmërisht nga pala gjermane. Në Kosovë marrëveshja e vitit 1968 tashmë prej vitesh nuk merret më në konsideratë në formën e caktuar atëherë.

Për këtë arsye shpjegimet e kësaj broshure mund të tregojnë vetëm gjendjen aktuale gjatë prodhimit të saj. Një ndryshim është i mundshëm në çdo kohë - edhe me afat të shkurtër. Prandaj ne, për fat të keq, nuk mund të marrim përsipër asnjë përgjegjësi për saktësinë.

Ju lutemi, informohuni prandaj për një njoftim aktual dhe të detyrueshëm gjithmonë direkt tek bartësi i sigurimit që është kompetent për ju!

Pasqyra e lëndës

- 4 Historia e marrëveshjes së vitit 1968
- 6 Si zbatohet sot marrëveshja e vitit 1968 në raport me Kosovën
- 8 I siguruar me sigurim të detyrueshëm
- 9 Të jeni anëtar vullnetar në Gjermani
- 13 Kthimi i kontributeve gjermane
- 17 Rehabilitimi – përsëri i gatshëm për jetën e përditshme dhe punën
- 20 Kushtet bazë të pensioneve gjermane
- 26 Pensione nga sigurimi pensional gjerman
- 28 Pensioni gjerman i duhur për ju
- 38 Pensioni në Kosovë
- 40 Kërkesa për pension dhe fillimi i pensionit
- 43 Llogaritja e pensionit
- 46 Pagesa e pensionit edhe jashtë vendit
- 48 Sigurimi shëndetësor dhe ai i përkujdesit tek pensionistët
- 50 Partnerët tuaj të kontaktit
- 52 Vetëm një hap larg: Sigurimi juaj pensional

Historia e marrëveshjes së vitit 1968

Marrëveshja ndërshtetërore me Ish-Jugosllavinë rregullon sigurinë sociale të njërit prej grupeve më të mëdha imigrantësh në Gjermani.

Gjatë viteve 1950 dhe 1960 shumë krahë pune erdhën nga jashtë vendit për në Gjermani. Sigurimi social i të ashtuquajtur 'Gastarbeiter' [punëtorëve emigrantë] duhej të rregullohej atëherë me vendlindjen e tyre. Kështu janë lidhur marrëveshjet e para të sigurimeve shoqërore.

Marrëveshja midis Gjermanisë dhe Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë e dt. 12 tetor të vitit 1968 hyri në fuqi gjatë vitit 1969. Me shpërbërjen e Jugosllavisë që prej vitit 1991 marrëveshja vllente më tej për shtetet e sapokrijuara në këtë territor si dhe fillimisht po ashtu për Jugosllavinë e mbetur, pastaj për konfederatën e Serbisë me Malin e Zi dhe më në fund për Republikën e Serbisë.

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt të vitit 2008 kjo marrëveshje nga këndvështrimi gjerman zbatohet gjerësisht edhe për shtetin e Kosovës.

Aktualisht marrëveshja e vjetër gjermano-jugosllave duhet të merret në konsideratë edhe më tej për shtetet Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi dhe Serbi.

Kroacia, Maqedonia dhe Sllovenia lidhën në vazhdim marrëveshje të veta ndërshtetërore me Gjermaninë. Që nga aderimi i Sllovenisë (më 1 maj 2004) dhe Kroacisë (me 1 korrik 2013) në Bashkimin Evropian në këto dy shtete vlen e drejta e përbashkët evropiane.

Ju lutemi, vini re:

Kosova së fundi ishte krahinë autonome në Serbi. Pavarësia e Kosovës pas shpalljes së dt. 17 shkurt 2008 nuk është njohur përgjërësisht. Veçanërisht Serbia e konsideron Kosovën edhe më tej si pjesë e shtetit të vet. Nga këndvështrimi i sigurimit pensional gjerman Kosova është një shtet i pavarur.

Nëse zbatohet marrëveshja e vitit 1968, atëherë të gjitha territoret e shteteve dhe të gjithë shtetasit e shteteve për të cilët vlen akoma rregullorja e kësaj marrëveshjeje, trajtohen në mënyrë të barabartë. Momentalisht këto janë Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi dhe Serbi. Për disa çështje nuk luan atëherë asnjë rol, nëse të siguruarit janë banorë të Malit të Zi ose nënshtetas të Kosovës. Edhe përvojat e sigurimeve pensionale të këtyre katër shteteve konsiderohen si përvojat e një shteti. E njëjta gjë vlen edhe për gjendjet në Kroaci, Maqedoni dhe Slloveni deri në hyrjen në fuqi të marrëveshjes përkatëse të re me atë shtet.

Sugjerimi ynë:

Ndikimet e këtij barazimi të territoreve të shteteve dhe të shtetasve të zbatuesve të marrëveshjes së vjetër nga viti 1968 i gjeni në këtë broshurë, të shpjeguara konkretisht në çdo pikë referimi.

Si zbatohet sot marrëveshja e vitit 1968 në raport me Kosovën




Të përfshirë janë para se gjithash shtetas të Kosovës, të cilët dikur kanë punuar në Gjermani si dhe emigrantë gjermanë, të cilët jetojnë dhe punojnë në Kosovë.

Marrëveshja vlen për të gjithë shtetasit e Gjermanisë dhe të Kosovës. Përveç kësaj ajo mund të zbatohet edhe në rast të shtetësive të tjera, nëse përvoja të sigurimeve shoqërore janë realizuar në Gjermani dhe në Kosovë.

Shembull:

Ivan B. Është shtetas maqedonas. Meqenëse ai ka punuar edhe në Kosovë edhe në Gjermani, për atë duhet të zbatohet marrëveshja e sigurimeve shoqërore e vitit 1968.

Marrëveshja vlen për

-  sigurimin ndaj aksidenteve,
-  sigurimin shëndetësor dhe
-  sigurimin pensional.

Marrëveshja ju ndihmon në plotësimin e kushteve për një përfitim duke trajtuar rrethana të caktuara në të dyja shtetet në mënyrë të barabartë.

Përveç kësaj gjatë zbatimit të dispozitave përkatëse ligjore, në të cilat bëhet fjalë për shtetësinë ose vendbanimin, shtetësia dhe vendbanimi barazohen me ato të shtetit tjetër të marrëveshjes. Prandaj ju mund të përfitoni pensionin gjerman për shembull edhe në Kosovë, në shumicën e rasteve, në shumën e plotë.

Vërejtje anësore: Për pagesën e pensionit, ju lutemi, lexoni edhe faqen 46.

I siguruar me sigurim të detyrueshëm

Një pension merrni vetëm, nëse më parë keni paguar kontribute për sigurimin ligjor pensional.

Një detyrim për t'u siguruar në sigurimin pensional krijohet parimisht sipas dispozitave ligjore të shtetit në të cilin jeni i punësuar. Sapo të punoni në Gjermani, vlejnjë parimisht vetëm dispozitat e ligjeve gjermane. Punëdhënësi juaj atëherë do t'ia paguajë kontributet sigurimit pensional gjerman.

Sugjerimi ynë:

Ruani mirë të gjitha dëshmitë, të cilat merrni nga punëdhënësit tuaj (për shembull dëshmitë për rrogën).

Nëse ju punoni në Kosovë, atëherë vlen e drejta e Kosovës. Edhe ndërrime (të disahershme) midis të dy shteteve janë të mundshme. E njëjta gjë vlen natyrisht, nëse ju keni qenë i punësuar në një apo më shumë shtete të tjera.

Ju lutemi, vini re:

Në Kosovë, që prej vitit 1999 nuk ekziston më asnjë sistem pensional të bazuar në kontribute. Ju lutemi, lexoni për këtë edhe faqen 38 dhe në vijim.

Të jeni anëtar vullnetar në Gjermani

Me kontribute vullnetare mund ta ngrini pensionin tuaj gjerman, mund të fitoni për herë të parë një të drejtë për pension ose mund të mbushni boshllëqet në biografinë tuaj të sigurimeve.

Nëse ju banoni në Gjermani dhe nuk duhet të paguani kontribute të detyrueshme, pavarësisht nga nënshtetësia juaj, ju mund të siguroheni vullnetarisht në sigurimin pensional gjerman. Për këtë duhet të jeni të paktën 16 vjeç/e. Shtetësia juaj nuk ka rëndësi.

Si gjerman ju, përveç kësaj dhe pavarësisht nga vendbanimi, mund të siguroheni në të gjithë botën gjithmonë vullnetarisht në Gjermani.

Sugjerimi ynë:

Informacione më të hollësishme përmban broshura jonë "Freiwillig rentenversichert: Ihre Vorteile"

Vërejtje anësore: Kjo broshurë mund të merret vetëm në gjuhën gjermane.

Pavarësisht nga shtetësia e tij dhe nga vendbanimi i tij secili që para dt. 19 tetor të vitit 1972 ka paguar të paktën një kontribut vullnetar, parimisht mund të sigurohet vullnetarisht në Gjermani.

Ju jeni kosovar dhe banoni në Bashkimin Evropian, ju mund të siguroheni vullnetarisht, nëse keni paguar tashmë një kontribut për sigurimin pensional gjerman.

Nëse jetoni në Kosovë, ju pa parakusht tjetër mund të paguani kontribute vullnetare.

Ju lutemi, vini re:

Ju mund të siguroheni vullnetarisht edhe atëherë pa asnjë kontribut të mëparshëm, nëse ju si kosovar jetoni në Bosnjë-Hercegovinë, Malin e Zi ose në Serbi. Ky rregull ekziston, sepse për Bosnjë-Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi dhe Serbinë vazhdon të zbatohet marrëveshja gjermano-jugosllave e vitit 1968.

Vërejtje anësore: Këto dispozita mund të zbatohen shpesh herë edhe për refugjatët. Ju lutemi, informohuni.

Nëse ju banoni në një tjetër shtet të huaj (për shembull në Meksikë ose Maqedoninë e Veriut) në shumicën e rasteve nuk lejohet që të siguroheni vullnetarisht. Ju lutemi, lejoni që të këshilloheni.

Kontribute vullnetare: Avantazhet tuaja

Me kontribute vullnetare ju mund ta plotësoni kohën minimale të pritjes për një pension gjerman. Por ju mund ta ruani edhe mbrojtjen tuaj të sigurimit për një pension për shkak të uljes së pjesshme ose të plotë të aftësisë për punë.

Sugjerimi ynë:

Për këto pensione mund të jetë me rëndësi që të dëshmoni kohën nga dt. 1 janar i vitit 1984 deri më sot pa boshllëqe me të ashtuquajtura kohët për ruajtjen e të drejtës. Ju duhet të këshilloheni për mundësitë tuaja nëse largoheni nga sigurimi sigurimi ligjor pensional gjerman, dhe gjithsesi dëshironi të vazhdoni të keni të drejtë për një nga këto pensione.

Përveç kësaj, kontributet vullnetare rrisin pensionin tuaj të pleqërisë ose sigurimin e të afërmeve tuaj në rast vdekjeje. Si i vetëpunësuar, mund të siguroheni vullnetarisht për të krijuar një siguri për veten tuaj dhe të afërmit tuaj.

Pagesa e kontributeve

Shumën dhe numrin e kontributeve tuaja vullnetare ju e vendosni vet. Por ka kontribute minimale dhe maksimale. Ju nuk jeni i detyruar që t' i përmbaheni shumës së kontributit që keni zgjedhur një herë. Për të ardhmen ju mund të ndryshoni në çdo kohë shumën e kontributeve dhe pagesën mund ta ndërprisni edhe tërësisht. Kontribute vullnetare për vitin rrjedhës mund të paguani vetëm deri më dt. 31 mars të vitit pasues.

Vërejtje anësore: Vlerat aktuale të kontributeve i gjeni në internet nën www.deutsche-rentenversicherung.de.

Para se të filloni një sigurim vullnetar, duhet të kontaktoni me institucionin tuaj të sigurimit të pensionit. Ne ju rekomandojmë që t' i paguani kontributeve pa para në dorë, qoftë nga llogaria juaj apo nga ajo e një të autorizuari në një institucion financiar në Gjermani. Edhe një transferim nga brenda ose jashtë vendit është i mundshëm.

Ju lutemi, vini re:

Sigurimi i pensioneve nuk merr përsipër asnjë shpenzim bankar, shpenzim për transferimin ose ndonjë shpenzime tjetër për transferimin. Në rast të pagesave nga jashtë vendit duhet që të paguani shumën në Euro për të përjashtuar diferenca të kursit.

Partnerët tuaj të kontaktit

Nëse ju dëshironi të parashtroni një kërkesë për sigurimin vullnetar, drejtohuni, ju lutemi, bartësit të sigurimit, në të cilin llogaria juaj e sigurimit në Gjermani mbahet.

Nëse ju banoni në Gjermani dhe nuk keni paguar asnjëherë kontribute për sigurimin ligjor pensional gjerman, ju mund ta paraqisni kërkesën tek çdo bartësi i sigurimit.

Ju nuk jeni i sigurt, cili bartës i sigurimit është kompetent për ju? Na pyesni neve. Për këtë ju mund të shfrytëzoni në Gjermani telefonin tonë të shërbimit që është falas ose në të gjithë botën adresën tonë të e-mailit.


Vërejtje anësore: Ju lutemi, lexoni kapitullin tonë „Vetëm një hap larg: Sigurimi juaj pensional“.


Kthimi i kontributeve gjermane


Nëse në Gjermani keni punuar dhe paguar kontribute vetëm për një kohë të caktuar dhe tani ktheheni në vendlindjen tuaj, ju ndoshta dëshironi që t'ju kthehen kontributet tuaja gjermane. Nëse kjo mundësi ekziston për ju, këtë e mësoni në këtë kapitull. Por ju duhet të mendoni mirë për këtë hap.

Me kthimin e kontributeve shuhen marrëdhëniet e sigurimit. Por kjo, sipas mendimit bazë, duhet të bëhet vetëm, nëse ju jeni larguar shumë nga rrethi i veprimit i sigurimit pensional gjerman, ose nga kontributet tuaja nuk mund të nxirrni asnjë të drejtë.

Ju mund ta kërkontë kompensimin nëse ju

 jeni larguar nga detyrimi gjerman për t' u siguruar.

 nuk mund të siguroheni vullnetarisht në Gjermani edhe

 n.q.s. nga momenti i largimit nga detyrimi gjerman për t' u siguruar kanë kaluar të paktën 24 muaj.

Afati i pritjes prej të paktën 24 muajsh duhet të respektohet. Dhe ndërkohë nuk duhet të ketë filluar një detyrim i ri për t' u siguruar.

Detyrimi për t' u siguruar në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian ose në një vend me të cilin Gjermania ka lidhur një marrëveshje mbi sigurimet shoqërore, në këtë kontekst mund të barazohet me detyrimin për t' u siguruar në Gjermani. Mundësia e kthimit të kontributeve nuk ekziston atëherë.

Vërejtje anësore: Ju lutemi, lejoni që të këshilloheni.

Sugjerimi ynë:

Nëse lejohet që ju të siguroheni vullnetarisht në Gjermani, këtë mësoni në kapitullin "Të jeni anëtar vullnetar në Gjermani". Lidhur me këtë nuk luan asnjë rol, nëse me të vërtetë dëshironi që të siguroheni vullnetarisht. Me rëndësi është vetëm nëse ju keni të drejtë për këtë. Nëse keni të drejtë për këtë, atëherë kthimi i kontributeve nuk mund të merret në konsideratë në rastin tuaj.

Rimbursimi për shkak të moshës

Nëse ju keni arritur kufirin e moshës së rregullt dhe keni paguar për më pak se pesë vjet, ju mund të bëni një kërkesë për kthimin. Mbrapa këtij rregulli është mendimi se me më pak se pesë vjet të pagesës së kontributeve nuk keni të drejtë për pension. Kontributet kthehen atëherë pa afatin e pritjes.

Vërejtje anësore: Kufiri i moshës së rregullt do të ngrihet hap pas hapi nga 65 në 67 vjeç/e.

Ju lutemi, vini re:

Në këto pesë vite llogariten edhe periudhat e sigurimit në Kosovë, në Bosnje dhe Hercegovinë, në Mal të Zi dhe në Serbi si dhe periudhat sipas së drejtës evropiane (për shembull në Kroaci ose Slloveni). Në raste të veçanta mund të merren parasysh edhe periudhat në Maqedoninë e Veriut deri në dhjetor 2004, por atëherë nuk mund të llogariten periudhat e BE-së, dhe periudhat e sigurimit në Kroaci mund të merren parasysh vetëm deri në nëntor 1998 dhe në Slloveni deri në gusht 1999. Edhe periudhat për të cilat nuk keni paguar vetë kontributet (për shembull, periudhat e rritjes së fëmijës) merren parasysh. Kështu, mund të keni të drejtë më vonë për një pension gjerman.

Vërejtje anësore: Mund të llogariten edhe përvojat nga vendet e tjera me një marrëveshje.

Pasjetuesit mund të kërkojnë kthimin e kontributeve të të ndjerit, nëse ky nuk ka paguar akoma kontribute për pesë vjet.

Nëse lejohet që kontributet tuaja të kthehen, me këtë marrëdhëniet e sigurimit me sigurimin pensional gjerman shuhen tërësisht. Ju nuk mund të ngrini më asnjë pretendim në bazë të kohëve të realizuara deri në atë moment.

Ju lutemi, vini re:

Kontributet gjermane nuk mund të rimbursohen nëse tashmë merrni një pension të huaj dhe ky pension mund të paguhet vetëm sepse kontributet gjermane dhe të huaja janë bashkuar. Kontributet gjithashtu nuk mund të rimbursohen nëse tashmë keni marrë prej tyre një përfitim, për shembull një rehabilitim.

Nëse ju rimbursohen kontributet tuaja, atëherë marrëdhënia juaj e sigurimit me sigurimin gjerman të pensioneve do të përfundojë plotësisht. Ju nuk mund të kërkonim më të drejta për asnjë periudhë sigurimi që keni përfunduar deri në atë moment.

Sugjerimi ynë:

ju lutemi, merrni këshillim të plotë , përpara se të kërkonim rimbursimin e kontributeve. Një pension i mëvonshëm mund të jetë alternativa më e mirë për ju.

Rimbursimi për të afërmit e të ndjerit

Të afërmit e të ndjerit mund të kërkojnë rimbursimin e kontributeve të të ndjerit, nëse ky i fundit nuk ka paguar kontribute për pesë vite.

Rimbursimi vetëm me kërkesë

Kontributet mund t' ju kthehen vetëm me kërkesë. Ju mund të paraqisni kërkesën tuaj edhe në mënyrë jo formale tek çdo bartës gjerman i sigurimit ose edhe në një ambasadë gjermane ose konsullatë gjermane në vend. Meqenëse lejohet që ju të paraqisni kërkesën edhe në gjuhën tuaj amtare, atëherë ju nuk keni nevojë të ngarkoni as një person ndërmjetës ose një të autorizuar ose një përkthyes me gojë.

Vërejtje anësore: Adresat e bartësve gjerman të sigurimit i gjeni në kapitullin „Vetëm një hap larg: Sigurimi juaj pensional“.

Ju lutemi, vini re:

Kontributet, si rregull, nuk kthehen në shumën e plotë! Punëmarrësit marrin për shembull vetëm pjesën e tyre të kontributeve të detyrueshme. Nga kontributet vullnetare kthehen vetëm gjysma e tyre dhe kontribute, të cilat nuk janë marrë përsipër nga ju, nuk mund të kthehen fare. Këtu përfshihen për shembull kontribute për shkak të edukimit të fëmijëve. Për kontributet nuk paguhen as interesa.

Shtetas gjerman

Si gjerman ju lejohet që t' ju kthehen kontributet gjermane parimisht vetëm atëherë, kur ju e keni arritur kufirin e moshës së rregullt dhe keni paguar më pak se 60 kontribute.

Rehabilitimi– përsëri i gatshëm për jetën e përditshme dhe punën

Një rehabilitim duhet t'ju ndihmojë të parandaloni ose të kapërceni kufizimet shëndetësore, në mënyrë që të mund të vazhdoni të merrni pjesë në jetën profesionale ose të integrohni përsëri.

Përveç rehabilitimit mjekësor, që mund të kryhet si trajtim ambulator ose stacionar, përfitimet për rehabilitim përfshijnë gjithashtu përfitimet për pjesëmarrjen në jetën profesionale, më parë të quajtura edhe “rehabilitim profesional,” parandalimin – si një masë parandaluese – dhe përfitimet e kujdesit pas trajtimit.

Ju lutemi, vini re:

Në përputhje me parimin "Reha para pensionit", para se të paguhet një pension për shkak të paaftësisë për të punuar, kontrollohet në përgjithësi nëse përmes një rehabilitimi mund të rikthehet aftësia juaj për punë.

Ju mund të përfitoni një rehabilitim nëse aftësia juaj për të punuar është në rrezik të madh ose tashmë është zvogëluar nga një sëmundje ose aftësi e kufizuar dhe kjo mund të rikthehet ose përmirësohet ndjeshëm përmes një rehabilitimi.

Shtetësia juaj nuk ka rëndësi. Megjithatë, duhet të jetoni në Gjermani ose të keni paguar një kontribut të detyruar në sigurimin gjerman të pensioneve në muajin kur keni paraqitur kërkesën për një përfitim.

Gjithashtu, duhet të plotësoni kushtet e sigurimit. Duhet të keni paguar kontribute për një periudhë të caktuar kohe – përgjithësisht për 5 ose 15 vjet – në sigurimin e pensioneve.

Ju lutemi, vini re:

Gjatë shqyrtimit të kushteve do të llogariten edhe periudhat tuaja të sigurimit në Kosovë si dhe të gjitha periudhat e sigurimit në Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi, dhe periudhat sipas së drejtës evropiane (për shembull në Kroaci ose Slloveni). Në raste të veçanta, mund të merren parasysh edhe periudhat në Maqedoninë e Veriut deri në dhjetor 2004, por atëherë nuk është e mundur të llogariten periudhat e BE-së dhe periudhat e sigurimit në Kroaci mund të merren parasysh vetëm deri në nëntor 1998 dhe në Slloveni deri në gusht 1999.

Për zgjedhjen e institucionit të përshtatshëm të rehabilitimit, ne përpiqemi të marrim parasysh sa më shumë dëshirat tuaja. Në portalin tonë të internetit www.meine-rehabilitation.de, mund të informoheni për klinikat e ndryshme të rehabilitimit dhe për shërbimet që ofrojnë secila prej tyre.

Sugjerimi ynë:

Informacione të hollësishme mbi përfitimet e rehabilitimit në Gjermani mund t'i gjeni në broshurat tona:

- ✎ "Mit Rehabilitation wieder fit für den Job“
- ✎ "Medizinische Rehabilitation: Wie sie Ihnen hilft“
- ✎ "Berufliche Rehabilitation: Ihre neue Chance“
- ✎ "Reha-Nachsorge: Therapieerfolg nachhaltig sichern“
- ✎ "Post-COVID: Mit Reha neue Kraft tanken“
- ✎ " Kinder und Jugendliche: Fit mit Rehabilitation“, erhältlich in deutscher Sprache sowie zehn Übersetzungen“
- ✎ "Reha: So wird Ihr Kind wieder gesund – in Leichter Sprache“

Kushtet bazë të pensioneve gjermane

Për të marrë një pension, ju duhet të plotësoni disa kushte.

Këtu përfshihen në shumicën e rasteve një moshë e caktuar e jetës dhe një përvojë minimale të sigurimit.

Këto dispozita për pensionin dhe për moshën e pensionit nuk janë njësoj në Gjermani dhe në Kosovë. Marrëveshja ju ndihmon që t' i plotësoni kushtet për një pension gjerman, por nuk siguron një përafrim të së drejtës së pensionit. Një pension gjerman të pleqërisë mund ta merrni jo më parë sesa me 61 vjeç, në rastin normal me mbi 65 vjeç. Në Gjermani kufiri i moshës së rregullt për të dalë në pension ngrihet që nga viti 2012 hap pas hapi nga përfundimi i moshës 65 në përfundimin e moshës 67 vjet të jetës. Në rrethana të caktuara, ju mund të merrni pensionin tuaj gjerman të pleqërisë para moshës standard të pensionit. Ju lutemi, lexoni për këtë edhe faqen 29 dhe në vijim.

Në Kosovë në vitin 1999 sistemi pensional u ndërrua nga një procedurë të financuar me kontribute në një procedurë të bazuar në taksa.

Vërejtje anësore: Informacione më të hollësishme mësoni në kapitullin "Pensioni në Kosovë".

Parimisht vlen: Kontribute, të cilat keni paguar në Gjermani, mbeten tek bartësi gjerman i sigurimit; përvojat tuaja të sigurimit në Kosovë tek sigurimi pensional në Kosovë. Secili vend, në të cilin keni qenë të siguruar, ju paguan një pension, nëse janë plotësuar kushtet për këtë në atë vend.

Nëse ju nuk i plotësoni kushtet për një pension vetëm me përvojat e këtij vendi, merren në konsideratë edhe përvojat në vendin tjetër të marrëveshjes. Kështu mund të merrni ndoshta akoma një pension.

Nëse ju për shembull nuk i keni plotësuar kushtet paraprake për të drejtën vetëm sipas së drejtës gjermane, atëherë përveç kësaj merren parasysh të gjitha përvojat të cilat keni realizuar në Kosovë. Llogariten të gjitha përvojat të cilat keni realizuar deri në rastin e përfitimit gjerman.

Përvojat e sigurimit në Kosovë mund të ekzistojnë vetëm deri në vitin 1999.

Sugjerimi ynë:

Gjatë verifikimit të kushteve mund të llogariten përveç përvojave tuaja të sigurimeve në Kosovë edhe të gjitha përvojat e sigurimeve në Bosnjë-Hercegovinë, në Mal të Zi dhe Serbi, si dhe periudhat sipas së drejtës evropiane (për shembull në Kroaci ose Slloveni). Në raste të veçanta, mund të merren parasysh periudhat në Maqedoninë e Veriut deri në dhjetor 2004, por atëherë nuk është e mundur të llogariten periudhat e BE-së, dhe periudhat e sigurimit në Kroaci mund të merren parasysh vetëm deri në nëntor 1998 dhe në Slloveni deri në gusht 1999.

Periudhat e sigurimit jashtë vendit duhet të na njoftohen nga enti i sigurimeve të pensioneve i shtetit përkatës.

Përvoja minimale e sigurimit

Kusht për çdo pension gjerman është që të keni paguar një numër të caktuar të kontributeve. Kjo përvojë minimal e sigurimit quhet edhe koha e pritjes. Sipas llojit të pensionit ajo përfshin 5, 35 ose 45 vjet.

Për kohët e pritjes prej 5 viteve llogariten të gjitha muajt në të cilët janë paguar kontribute të detyrueshme ose vullnetare për sigurimin pensional.

Këtu mund të llogariten edhe kohët e papunësisë, ato të edukimit të fëmijëve dhe të përkujdesjes në Gjermani.

Në rast të një kohe pritjeje prej 35 vitesh mund të llogariten, përveç kësaj, edhe muajt e sëmundjes, papunësisë, arsimit shkollor ose kohët që merren parasysh (në rast të edukimit të fëmijëve në Gjermani).

Për kohën e pritjes prej 45 vitesh nuk vlejnë të gjitha kohët sipas së drejtës pensionale. Kohët, për shembull, në të cilat ju keni qenë të papunë mund të merren parasysh vetëm në mënyrë të kufizuar.

Ju lutemi, vini re:

Natyrisht krahas përvojat e sigurimit gjerman llogariten edhe të gjitha përvojat, të cilat na verifikohen nga bartësit e sigurimit në Kosovë, në Bosnjë-Hercegovinë, në Mal të Zi ose Serbi. si dhe sipas së drejtës evropiane (për shembull në Kroaci ose Slloveni). Në raste të veçanta mund të merren parasysh periudhat në Maqedoninë e Veriut deri në dhjetor 2004, por atëherë nuk është e mundur të llogariten periudhat e BE-së dhe periudhat e sigurimit në Kroaci mund të merren parasysh vetëm deri në nëntor 1998 dhe në Slloveni deri në gusht 1999. Kështu nga sigurimi pensional gjerman ju mund të pretendoni një pension edhe atëherë, nëse ju në Gjermani keni paguar vetëm pak kontribute.

Vërejtje anësore: Informacione të tjera për përvojat gjermane gjeni në broshurën "Rente: Jeder Monat zählt".

Kushtet sipas së drejtës së sigurimit

Për disa pensione gjermane duhet të plotësoni, krahas kohës së pritjes, të ashtuquajtura kushte sipas së drejtës së sigurimit. Për këtë ju duhet të keni paguar brenda kohëve të caktuara një numër të caktuar të kontributeve të detyrueshme.

Vërejtje anësore: Kushtet sipas së drejtës së sigurimit për pensionet e veçanta ju gjeni që nga faqja 28.

Ju lutemi, vini re:

Kontributet e kërkuara të detyrueshme mund të plotësoni edhe me kontributet e detyrueshme në Bosnjë-Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi, si dhe kontributet e detyrueshme sipas së drejtës evropiane (për shembull në Kroaci ose Slloveni), të cilat keni paguar atje gjatë një punësimi ose vetëpunësimi.

Zbritja e pensionit

Shumica e pensioneve gjermane, të cilat merrni para arritjes së kufirit të moshës së rregullt për të dalë në pension, nuk paguhen në shumën e plotë, por ulen me një zbritje. Për secilin muaj, në të cilin e shfrytëzoni pensionin tuaj para kohe, pensioni juaj shkurtohet me 0,3 %.

Vërejtje anësore: Për kufirin e moshës së rregullt të pensionit, ju lutemi, lexoni që nga faqja 29.

Nëse ju keni lindur pas vitit 1963, atëherë mosha e rregullt për të dalë në pension është 67 vjeç. Zbritja më e lartë do të jetë atëherë 14,4 %.

Shembull:

Arlinda F. dëshiron ta shfrytëzojë pensionin e saj të pleqërisë një vit para arritjes së kufirit të moshës së rregullt për të dalë në pension. Zbritja e pensionit për këtë pension është 3,6 për qind (12 muaj x 0,3 për qind).

Ju mund të përcaktoni vet fillimin e pensionit tuaj dhe me këtë mund të ndikoni në shumën e zbritjes.

Ju lutemi, vini re:

Zbritja e pensionit mbetet në fuqi në sigurimin gjerman gjatë gjithë jetës suaj. Madje pas vdekjes suaj ajo ka akoma ndikim mbi një pension familjar. Ju lutemi, lejoni prandaj që të këshilloheni. Kjo është edhe e rëndësishme, sepse në disa raste ka përjashtime - të ashtuquajtura rregullat e mbrojtjes së besimit.

Pensionet dhe të ardhurat

Nëse ju merrni një pension për shkak të uljes së aftësisë për punë ose një pension pleqërie para kufirit të moshës së rregullt për të dalë në pension, të ardhurat si i punësuar ose si i vetëpunësuar mund të ndikojnë mbi shumën e pensionit. Edhe disa përfitime shoqërore duhet të merren parasysh si të ardhura.

Lidhur me këtë nuk luan asnjë rol, nëse këto të ardhurat i fitoni duke bërë ekonomi në Gjermani, në Kosovë ose në një vend tjetër. Tek pensionet për shkak të uljes së aftësisë për punë si të ardhurat mund të merren parasysh edhe disa përfitime sociale.

Nëse i kapërceni kufijtë e fitimit shtesë, pensioni juve ju shkurtohet ose nuk ju paguhet fare.

Ju mund të fitoni të ardhura shtesë pa kufizime krahas pensionit tuaj të pleqërisë.

Vërejtje anësore: Për kufirin e moshës së rregullt të pensionit, ju lutemi, lexoni që nga faqja 34.

Sugjerimi ynë:

Informacione të mëtejshme për të ardhurat shtesë gjeni në fletëpalosjet
“Altersrente: Unbegrenzt hinzuver- dienen“ si dhe
“Erwerbsminderungsrente: So viel können Sie hinzuverdienen“

Pensioni i vejërisë gjatë tre muajve të parë pas vdekjes së të sigurvearit paguhet në shumën plotë. Pastaj të ardhurat tuaja llogariten në pension. Vendimtare janë të ardhurat tuaja bruto, nga të cilat gjenden të ardhurat e përgjithësuara neto.

Për këtë zbriten kontributet e parashikuara me ligj, për shembull 40 për qind në rast të të punëmarrësve. Nëse të ardhurat e mbetura neto e tejkalojnë shumën e përjashtimit, atëherë llogariten 40 për qind të të ardhurave që janë mbi shumën e përjashtimit në pensionin familjar. Merren parasysh edhe përfitime sociale, pasuri dhe të ardhurat nga jashtë vendit.

Vërejtje anësore: Kushtet për këto pensione ju gjeni që nga faqja 34.

Shembull:

Ermira S. Jeton në Stuttgart dhe merr një pension gjerman të vejërisë nga sigurimi i burrit të vdekur të saj në shumën prej 406 Euro. Ajo fiton 2000 Euro bruto. Bartësi i sigurimit si paketë e përgjithësuar zbrit nga këto 40 për qind dhe me këtë gjen një shumë prej 1200 Euro. Pas zbritjes së një shume të përjashtimit për ve (momentalisht rreth 992,64 Euro) mbetet një shumë të ardhurash prej 207,36 Euro. Nga këto përcaktohen 40 për qind (82,94 Euro) dhe hiqen nga pensioni. Pra, Ermira S. merr një pension të vejërisë në shumën prej 323,06 Euro.

Për pensionet e jetimëve nuk llogaritet asnjë e ardhur e vetë jetimit.

Vërejtje anësore: Informacione të mëtejshme për llogaritjen e të ardhurave në pensionin familjar gjeni në broshurën „Hinterbliebenen- rente: So viel können Sie hinzuverdienen“.

Shtesa për pensionin bazë

Shtesa për pensionin bazë sipas së drejtës gjermane është – nëse plotësohen kushtet – një shtesë e llogaritur individualisht për një pension dhe nuk duhet të ngatërrohet me pensionin bazë në Kosovë, i cili sipas informacioneve tona paguhet si një shumë e caktuar fikse për pensionistët në Kosovë.

Më 1 janar 2021, në sigurimin gjerman të pensioneve është prezantuar një formë e re kompensimi social – shtesa për pensionin bazë, e quajtur edhe pension bazë. Me këtë shtesë për pension, individët që kanë punuar gjatë gjithë jetës së tyre dhe kanë fituar nën mesataren, do të marrin një mbrojtje më të mirë në pension. Ju nuk keni nevojë të paraqisni një kërkesë për këtë. Ne shqyrtojmë çdo pension për të parë nëse plotësohen kushtet për shtesën.

Kushti për këtë shtesë janë të paktën 33 vjet me periudha të quajtura kohë për pensionin bazë. Mund të merrni shtesën e plotë vetëm kur të keni 35 vjet me këto periudha. Kohët për pensionin bazë përfshijnë kryesisht periudhat kur janë paguar kontribute të detyrueshme për shkak të një punësimi dhe periudhat kur janë rritur fëmijët. Nga ana tjetër, për shembull, periudhat e papunësisë, arsimit shkollor ose periudhat me kontribute vullnetare nuk përfshihen.

Vërejtje anësore: Informacione të mëtejshme gjeni në broshurën „Grundrente: Zuschlag zur Rente“.

Për të paktën 33 vitet me kohë për pensionin bazë llogariten edhe periudhat e sigurimit në Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi, si dhe periudhat sipas së drejtës evropiane (për shembull në Kroaci ose Slloveni). Në raste të veçanta, mund të merren parasysh edhe periudhat në Maqedoninë e Veriut deri në dhjetor 2004, por atëherë nuk mund të llogariten periudhat e BE-së dhe periudhat e sigurimit në Kroaci mund të merren parasysh vetëm deri në nëntor 1998 dhe në Slloveni deri në gusht 1999.

Ju lutemi, vini re:

Shtesa për pensionin bazë llogaritet vetëm nga periudhat gjermane.

Periudhat me të ardhura të ulëta në Kosovë nuk përmirësohen nga shtesa.

Shtesa për pensionin bazë merret parasysh ndaj të ardhurave tuaja dhe, nëse është e mundur, të ardhurave të bashkëshortit ose partnerit tuaj të regjistruar, nëse kalohet një kufi i caktuar i të ardhurave.

Shtesa për pensionin bazë paguhet edhe jashtë vendit.

Pensioni gjerman i duhur për ju

Sigurimi pensional gjerman ju paguan një pension nëse nuk mund të punoni më për arsye shëndetësore, në pleqëri dhe në rast vdekjeje, të afërmeve tuaj.

Për secilin prej këtyre pensioneve, ju duhet të plotësoni disa kushte specifike. Në faqet në vijim, ne ju japim një pasqyrë të llojeve të ndryshme të pensioneve. Se si mund t'ju ndihmojë marrëveshja e vitit 1968 për kërkesën tuaj, mund ta mësoni në kapitujt "Kushtet themelore të pensioneve gjermane" dhe "Llogaritja e pensioneve


Sugjerimi ynë:


Nëse dëshironi të dini për cilin pension gjerman ju tashmë i plotësoni kushtet, ju mund të kërkonte tek bartësi juaj i sigurimit një njoftim për pensionin tuaj. Në këtë gjëni të gjitha informacionet.


Vërejtje anësore: Adresën e bartësit tuaj të sigurimit e gjeni që nga faqja 50.

Pensioni për shkak të uljes së aftësisë për punë

Këtë pension e merrni, nëse ju

 për shkak të sëmundjes ose aftësisë së kufizuar jeni të paaftë për të punuar,

 e plotësoni kohën e pritjes prej pesë viteve ose e plotësoni përpara kohe (për shembull për shkak të një aksidenti në punë) dhe

 në pesë viteve të fundit para hyrjes së paaftësisë për të punuar , të keni paguar tre vjet kontribute të detyrueshme për një punësim të siguar ose për një vetëpunësim ose nisur nga dt. 1 janar të vitit 1984 të keni plotësuar kohën e përgjithshme të pritjes prej pesë vitesh me kohët e kontributeve të detyrueshme dhe çdo muaj nga dt. 1 janar të vitit 1984 deri në hyrjen e rastit të përfitimit është dëshmuar me kohët për ruajtjen e të drejtës.

Vërejtje anësore: Ky pension paguhet jo më gjatë sesa deri në arritjen e kufirit të moshës së rregullt. Pastaj ju merrni automatikisht një pension të rregullt të pleqërisë.

Bartësi juaj i sigurimit të pensionit shqyrton me anë të dokumenteve mjekësore, nëse aftësia juaj për punë është e ulur pjesërisht apo plotësisht. Pensionin për shkak të uljes së plotë të aftësisë për punë ju e merrni, nëse ju mund të punoni më pak se tre orë në ditë. Nëse është e mundur për ju që të punoni me shumë se tre, por më pak se gjashtë orë në ditë, atëherë ju merrni një pension për shkak të uljes së pjesshme të aftësisë për punë. Ky është sa gjysma e pensionit në bazë të uljes së plotë të aftësisë për punë.

Një pension në bazë të uljes së aftësisë për punë merrni zakonisht zakonisht jepet për një periudhë të kufizuar për maksimumi tre vjet. Ajo mund të



zgjatet nëse kufizimet shëndetësore vazhdojnë të jenë të pranishme pas kësaj periudhe.

Sugjerimi ynë:

Informacione të hollësishme gjeni në broshurën "Erwerbsminderungsrente: Das Netz für alle Fälle".

Pensioni pleqërie të rregullt

Ju keni të drejtë për një pension pleqërie të rregullt, nëse ju

-  keni arritur moshën e pleqërisë dhe
-  keni plotësuar kohën e pritjes prej pesë vjetësh.

Për ata që kanë lindur pas vitit 1947, mosha e pleqërisë rritet gradualisht nga 65 në 67 vjeç.

Nëse keni lindur në vitin 1964 ose më vonë, e arrini moshën e pleqërisë në 67 vjeç. Pensioni i pleqërisë nuk mund të merret përpara kohe dhe për këtë arsye është gjithmonë i lirë nga zbritjet.

Ngritja e kufirit të moshës në 67 vjeç

Të sigurvearit Viti i lindjes	Ngritja në muaj	mbi moshën	
		vjeç	muaj
1947	1	65	1
1948	2	65	2
1949	3	65	3
1950	4	65	4
1951	5	65	5
1952	6	65	6
1953	7	65	7
1954	8	65	8
1955	9	65	9
1956	10	65	10
1957	11	65	11
1958	12	66	0
1959	14	66	2
1960	16	66	4
1961	18	66	6
1962	20	66	8
1963	22	66	10
1964	24	67	0

Sugjerimi ynë:

Informacione të hollësishme për të gjithë pensionet e pleqërisë përmban broshura "Die richtige Altersrente für Sie".

Pensionet e tjera të pleqërisë

Edhe nëse nuk keni arritur ende moshën e pleqërisë së zakonshme, mund të merrni një pension gjerman për pleqëri nën kushte të caktuara.



Pensionin për personat që kanë qenë të sigurvear për një kohë të gjatë dhe pensionin për personat me aftësi të kufizuara të rënda mund ta merrni edhe para kohe. Çdo muaj që e merrni pensionin para kohe ju kushton 0.3 për qind zbritje. Zbritja vlen përgjithmonë.

Ju lutemi, vini re:

Pasi të keni vendosur të përfitoni një pension, më pas nuk mund të kaloni në një pension tjetër të pleqërisë (me zbritje më të vogla). Prandaj, sigurohuni të konsultoheni me ne më parë. Kjo është e rëndësishme edhe sepse në disa raste ka rregulla të veçanta përjashtimi. Kontaktoni përfaqësuesit tanë duke filluar nga faqja 50.

Pensioni i pleqërisë për ata që kanë qenë të siguruar për një periudhë shumë të gjatë

Ju keni të drejtë të përfitoni këtë pension nëse:

-  jeni mbi 63 vjeç dhe
-  keni plotësuar kohën e pritjes prej 45 vjetësh.

Për ata që kanë lindur pas vitit 1953, mosha e pleqërisë rritet gradualisht nga 63 vjeç. Nëse keni lindur në vitin 1964 ose më vonë, mosha e pleqërisë do të jetë 65 vjeç.

Rritja e kufirit të moshës për pensionin e pleqërisë për ata që kanë qenë të siguruar për një periudhë shumë të gjatë

Të sigurvearit Viti i lindjes	Ngritja në muaj mbi moshën	
	vjeç	muaj
1958	64	0
1959	64	2
1960	64	4
1961	64	6
1962	64	8
1963	64	10
1964	65	0

Pensioni i pleqërisë për ata që kanë qenë të siguruar për një periudhë shumë të gjatë paguhet pa zbritje. Nuk mund të merret përpara kohe.

Pensionin e pleqërisë për ata që kanë qenë të siguruar për një kohë të gjatë

Ju mund ta merrni këtë pension nëse:

- ✎ jeni 63 vjeç dhe
- ✎ keni plotësuar kohën e pritjes prej 35 vjetësh.

Për të gjithë ata që kanë lindur pas vitit 1949, kufiri i moshës së pleqërisë rritet gradualisht nga 65 vjeç. Nëse keni lindur në vitin 1964 ose më vonë, kufiri i moshës do të jetë 67 vjeç. Ju mund të merrni pensionin e pleqërisë para kohe në moshën 63-vjeçare, por me një zbritje të pensionit deri në 14.4 për qind.

Si përfitues i një pensioni pleqërie të rregullt ju lejohet të keni fitime të pakufizuara shtesë dhe as nuk duhet të keni frikë për zbritje.

Rritja e kufirit të moshës për pensionin e pleqërisë për ata që kanë qenë të siguruar për një kohë të gjatë




Të sigurvearit Viti i lindjes	Ngritja në muaj mbi moshën		Zbritje në përqindje kur fillon pensioni në moshën 63 vjeç
	vjeç	muaj	
1959	64	2	11,4
1960	64	4	12,0
1961	64	6	12,6
1962	64	8	13,2
1963	64	10	13,8
1964	65	0	14,4

Shembull:

Skender D. do të mbushë 63 vjeç më 27 shtator 2023. Ai dëshiron të fillojë të marrë pensionin e pleqërisë për ata që kanë qenë të siguar për një kohë të gjatë duke filluar nga 1 tetori 2023. Kjo do të fillojë 40 muaj para arritjes së kufirit të moshës së pleqërisë dhe, për këtë arsye, do të zvogëlohet me 12 për qind (40 muaj \times 0,3 për qind).

Pension pleqërie për njerëz me aftësi të kufizuara rëndë

Ju keni të drejtë për këtë pension, nëse ju

-  jeni pranuar si person me aftësi të kufizuara të rëndë sipas ligjit gjerman,
-  jeni mbi 61 vjeç dhe
-  keni plotësuar kohën e pritjes prej 45 vitesh.

Kufiri i moshës për këtë pension po rritet gradualisht për ata që kanë lindur nga viti 1952 deri më 1963. Për të gjithë ata që kanë lindur pas vitit 1964, kufiri i moshës është 65 vjeç, ndërsa për pensionin me zbritje është 62 vjeç. Ju mund ta merrni pensionin edhe para kohe, por duhet të pranoni zbritje të pensionit prej 0.3 për qind për çdo muaj që merrni pensionin para kohe (maksimumi 10.8 për qind).

Rritja e kufirit të moshës për pensionin e pleqërisë për personat me aftësi të kufizuara të rëndë

Të siguarit Viti i lindjes	Ngritja në muaj mbi moshën		Viti më i hershëm i mundshëm Fillimi i pensionit me zbritje prej 10,8 për qind nga	
	vjeç	muaj	vjeç	muaj
1958	64	0	61	0
1959	64	2	61	2
1960	64	4	61	4
1961	64	6	61	6
1962	64	8	61	8
1963	64	10	61	10
1964	65	0	62	0

Ju mund të përfitoni pensionin për personat me aftësi të kufizuar të rëndë vetëm nëse jeni pranuar si person me aftësi të kufizuar të rëndë sipas ligjit gjerman me një shkallë të aftësisë së kufizuar (GdB) prej të paktën 50, që do të thotë se mund të paraqisni një certifikatë për këtë. Këtë vendim nuk e merr institucioni i pensioneve, por Zyra e Mirëqenies. Nëse jetoni në Kosovë, për këtë është përgjegjëse Zyra e Mirëqenies dhe e Shërbimeve Sociale në Hessia, Fulda.

Pensione për vejanë dhe vejane

Pas vdekjes së bashkëshortit/bashkëshortes ju mund të merrni pension për vejanë dhe vejane, nëse bashkëshorti/bashkëshortja (deri në vdekje) e ka plotësuar kohën e pritjes prej pesë viteve. ose e ka plotësuar këtë (për shembull, për shkak të një aksidenti në punë) para kohe. Bashkëshorti i mbijetuar nuk duhet të ketë rimartuar.

Ju lutemi, vini re:

Personat që kanë hyrë në një partneritet të regjistruar homoseksual janë të barabartë me bashkëshortët. Gjithashtu, partnerët e një martese homoseksuale kanë të drejtë të marrin pensionin e vejës ose të vejanit.

Vërejtje anësore: Pas një ndarjeje të pensionit, bashkëshorti i mbijetuar nuk ka të drejtë për pensionin e vejës ose të vejanit.

Për të marrë një pension, bashkëshortët duhet të kenë qenë të martuar për të paktën një vit në momentin e vdekjes. Kjo periudhë minimale prej një viti nuk vlen nëse jeni martuar para 1 janarit 2002 ose nëse martesë nuk është kryer për arsye të përfitimeve (për shembull, në rastin e vdekjes aksidentale të bashkëshortit).

Pensioni për vejanë dhe vejane mund të paguhet si pension i vogël ose i madh. Për të marrë një pension të madh, ju duhet

✎ të jeni të paktën 45 vjeç/e (për vdekje nga viti 2012 deri më 2029, ngritje graduale në moshën 47 vjeç) ose

✎ të keni aftësi të kufizuar për punë

✎ të edukoni një fëmijë, ose të kujdeseni për një fëmijë të të ndjerit, i cili ende nuk është 18 vjeç ose

✎ në bashkësi shtëpiake të kujdeseni për fëmijë tuajin ose për një fëmijë të të ndjerit i cili për shkak të kufizimit fizik nuk është në gjendje që të kujdeset për vetveten.

Vërejtje anësore: Kufiri i moshës ngrihet hap pas hapi nga 45 vjeç/e në moshën 47 vjeç/e. Lexoni edhe broshurën "Rente mit 67 – Wie Sie Ihre Zukunft planen können?".

Pensioni i madh për vejanë dhe vejane paguhet vazhdimisht. Ai është 55 ose 60 për qind të pensionit të të siguarit.

Nëse keni qenë të martuar para 1 janarit 2002 dhe të paktën njëri nga bashkëshortët ka lindur para 2 janarit 1962, pensioni i madh i vejës ose i vejanit përbën 60 për qind të pensionit të të siguarit.

Vërejtje anësore: Kush është martuar para vitit 2002 dhe ka lindur para vitit 1962, merr 60 për qind.

Nëse asnjëri prej këtyre kushteve nuk është i plotësuar, ju pas vdekjes së të siguarit merrni një pension të vogël për vejanë dhe vejane. Ajo përbën 25 për qind të pensionit të të siguarit dhe paguhet për jo më shumë se 24 muaj kalendarikë pas vdekjes së të siguarit. Nëse jeni martuar para 1 janarit 2002 dhe të paktën njëri nga bashkëshortët ka lindur para 2 janarit 1962, pensioni i vogël do të paguhet pa afat të caktuar.

Nëse ju si vejan ose vejane martoheni përsëri, ky pension anulohet. Ju me kërkesë mund të merrni një kompensim pensioni. Ky është 24 pensione mujore në maksimum.

Shembull:

Pensionisti Nusred B. ka vdekur në maj 2013. E veja e tij Dora B është 58 vjeçe dhe prandaj ajo merr një pension të madh për vejane. Në gusht të vitit 2022 ajo martohet përsëri, gjë që çon në anulimin e pensionit për ve më dt. 31 gusht 2022. Në dymbëdhjetë muajt para anulimit të pensionit (shtator 2021 deri në gusht 2022) Dora B. ka marrë mesatarisht 520 Euro pension për vejane. Kompensimi është 24-fishi i kësaj shume mesatare, pra 12 480 Euro.

Pensioni për jetimë

Një pension për jetimë (pension për gjysmë jetimë) mund të paguhet pas vdekjes së njërit prej prindërve, nëse ky prind
✎ deri në momentin e vdekjes ka marrë një pension ose
✎ në momentin e vdekjes ka plotësuar periudhën e nevojshme të sigurimit prej pesë vjetësh ose kjo është plotësuar para kohe (për shembull, për shkak të një aksidenti në punë).

Nëse vdes edhe prindi i dytë, paguhet një pension për fëmijët e mbetur pa prindër.

Një pension për jetime merrni si fëmijë biologjik ose fëmijë i birësuar i të vdekurit. Edhe fëmijë të gjetur, fëmijë në shpirt, nipat dhe mbesat ose vëllezër dhe motra mund të marrin një pension të tillë.

Pensioni për jetime paguhet deri në ditëlindjen e 18-të. Nëse ju jeni më i madh në moshë dhe ndodheni akoma në arsim shkollor ose formim profesional, pensioni paguhet edhe më tej, por jo më gjatë sesa deri në ditëlindjen e 27-të. Formimi duhet të konfirmohet në distanca të rregullta kohore nga shkolla juaj ose shkolla juaj e lartë ose nga punëdhënësi juaj.

Pensione të tjera për shkak të vdekjes

Nëse ju jeni shkurorëzuar dhe bashkëshorti juaj i mëparshëm ka vdekur, pas 30 qershorit 1977, atëherë ju mund të keni një të drejtë për një pension edukimi. Ky pension ju paguhet nga përvojat tuaja e sigurimit, nëse ju edukoni një fëmijë. E njëjta gjë vlen për partnerët e regjistruar të jetës.

Një pension për vejanë ose vejane pas bashkëshortit të parafundit ne paguajmë, nëse jeni rimartuar ose keni krijuar një partneritet të regjistruar dhe lidhja e re është tani e shpërbërë ose anuluar (për shembull për shkak të vdekjes).

Nëse martesë u shkurorëzua para dt. 1 korrik 1977, pas vdekjes së paguesit të mbajtjes, mund të paguhet një pension për vejanë dhe vejane të shkurorëzuar/a.

Vërejtje anësore: Hollësiat për këto pensione përmban broshura "Hinterbliebenenrente: Hilfe in schweren Zeiten".

Pensioni në Kosovë

Mbi të drejtën e pensionit në Kosovë vendosin vetëm autoritetet kompetente atje.

Deri në vitin 1999 në Kosovë ka pasur një sistem pensional që ishte i ngjashëm me atë gjerman. Ishin tërhequr kontribute dhe pensionet ishin llogaritur dhe paguar në bazë të këtyre pagesave të kontributeve.

Gjatë vitit 1999 sistemi ligjor i sigurimit pensional u ndryshua rrënjësisht. Numri i kontributeve të paguara dhe shuma e këtyre kontributeve janë tani krejt të parëndësishëm për të drejtën e pensionit dhe shumën e pensionit.

Rrethit të personave me të drejtë për një pension të tillë bazë i përkasin krahas njerëzve të moshuar dhe persona invalidë. Sipas informacioneve tona pensioni në Kosovë paguhet si shumë pakete të përgjithësuar. Lidhur me këtë, kjo shumë është njësoj për të gjithë pensionistët.

Një pagesë e këtij përfitimi jashtë vendit nuk bëhet. Pensionin e marrin atëherë sipas dispozitave të Kosovës vetëm pensionistët që jetojnë në Kosovë.

Sugjerimi ynë:

Pavarësia ende e re e Kosovës do të ketë si pasojë me siguri ndryshime të shumëllojshme - atëherë edhe në të drejtën e pensionit. Prandaj në këtë broshurë nuk mund të jepen sqarime të detyrueshme për të drejtën e pensionit në Kosovë. Ende nuk dihet nëse me afat të mesëm planifikohet kthimi për një sistem shtetëror, të financuar në bazë të kontributeve.

Ju lutemi, drejtohuni prandaj për njoftime të detyrueshme për çështje juridike direkt bartësit të sigurimit pensional në Kosovë.

Vërejtje anësore: Adresën e bartësit të sigurimit në Kosovë e gjeni që në faqen 51.

Edhe pse kontributet e paguara për sigurimin pensional në Kosovë (deri në vitin 1999) nuk janë më relevante për pensionin e atjeshëm, këto përvoja të sigurimit konfirmohen me kërkesë për bartësit të sigurimit pensional gjerman. Për llogaritjen e përvojave të sigurimit në kuadrin e marrëveshjes për konstatimin e një të drejte për një pension gjermane ne mund t' i marrim edhe më tej në konsideratë përvojat e sigurimit në Kosovë.

Vërejtje anësore: Kushtet për pensionet gjermane i gjeni që nga faqja 20.

Ju lutemi, vini re:

Kontributet e derdhura në sistemin e kursimit pensional të detyrueshëm, të financuar privatisht në Kosovë, nuk përbëjnë kontribute të detyruara të një sistemi sigurimi ligjor pensional në pikpamje të marrëveshjes. Përvoja të tilla të sigurimit nuk përfshihen nga marrëveshja, atëherë ato nuk mund të merren parasysh. Thëniet për përfitimet nga ky sistem privat nuk janë të mundshme. Ju lutemi, drejtohuni për këtë direkt zyrës kompetente në Kosovë

Kërkesa për pension dhe fillimi i pensionit

Një pension merr vetëm ai që paraqet një kërkesë. Në këtë kapitull mësoni kur fillon një pension gjerman dhe ku mund të paraqisni kërkesën tuaj.

Pensioni juaj gjerman fillon, si rregull, me të parin e muajit kalendarik, në fillim të cilit ju i plotësoni kushtet.

Shembull:

Ortisa N. E arrin kufirin e moshës së rregullt për të dalë në pension më 12 prill 2023. Nga ky moment ajo i ka plotësuar të gjitha kushtet. Pensioni i saj fillon më 1 maj 2023.

Që të jemi në gjendje t' ju paguajmë pensionin tuaj në mënyrë të përpiktë, ju duhet ta paraqisni kërkesën tuaj në kohë. Ju keni tre muaj të plotë kalendarikë kohë pas plotësimit të kushtit të fundit. Nëse e paraqisni kërkesën më vonë, atëherë pensioni juaj fillon vetëm me muajin e paraqitjes së kërkesës.

Shembull:

Ortisa N. e paraqet kërkesën për pension vetëm më 26 gusht të vitit 2023. Meqenëse rasti i përfitimit tashmë ka qenë para tre muajve, pensioni i saj fillon vetëm më 1 gusht 2023.

Përjashtime nga ky rregull ka vetëm në rast të pensioneve në bazë të uljes së aftësisë për punë dhe të pensioneve familjare. Një pension i kufizuar në kohë për shkak të uljes së aftësisë për punë paguhet në rastet e rregullta vetëm që nga muaji i 7-të kalendarik pas fillimit të uljes së aftësisë për punë. Nëse paraqitja e kërkesës bëhet vetëm pas muajit të 7-të kalendarik, pensioni fillon me muajin e paraqitjes së kërkesës. Një pension familjar paguhet edhe me

Një pension familjar paguhet edhe me prapaveprim dhe pikërisht për një kohë deri në dymbëdhjetë muaj kalendarikë para muajit në të cilin është bërë kërkesa për pension.

Ne ju rekomandojmë që ta paraqisni kërkesën për një pension pleqërie rreth tre muaj para fillimit të pensionit. Atëherë edhe organe të treta, siç janë p.sh. punëdhënës ose arka shëndetësore, kanë kohë të mjaftueshme për të na transmetuar të gjitha informacionet e nevojshme.

Ju lutemi, vini re:

Koha e paraqitjes së kërkesës për pension është shumë e rëndësishme, në mënyrë që të mos humbni asnjë të drejtë.

Vërejtje anësore: Adresat e qendrave tona informuese dhe këshilluese i merrni në telefonin e shërbimit pa pagesë ose i gjeni në internet. Lexoni për këtë, ju lutemi, kapitullin „Vetëm një hap larg: Sigurimi juaj pensional“.

Ku mund ta paraqes kërkesën për pension?

Nëse i keni realizuar përvojat e sigurimit në Gjermani dhe në Kosovë, atëherë ju duhet të paraqisni vetëm një kërkesë për pension.

Vendbanim në Gjermani

Nëse jetoni në Gjermani, mund të paraqitni kërkesën tuaj te institucioni përgjegjës për ju i Sigurimeve Gjermane të Pensioneve. Ju lutemi shënoni këtu nëse keni punuar edhe në Kosovë. Ne mund të kërkojmë periudhat e sigurimit në Kosovë nga autoritetet përkatëse. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse periudha e nevojshme për pensionin gjerman nuk mund të plotësohet pa periudhat në Kosovë.

Sugjerimi ynë:

Ju lutemi, për një takim në njërin prej zyrave të njoftimit dhe të këshillimit, sillni me vete dokumentacionin tuaj të sigurimit dhe një letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme.

Në formularin gjerman për kërkesën e pensionit përfshihet një pyetje për përvojat e sigurimit jashtë vendit. Nëse ju shënoni këtu që keni punuar edhe në Kosovë, atëherë bartësi gjerman mund t' i kërkojë përvojat e sigurimit në Kosovë.

Por sipas informacioneve që disponojmë ne, nuk merrni një pension nga Kosova, nëse jetoni në Gjermani.

Vërejtje anësore: Lexoni për këtë edhe kapitullin "Pensioni në Kosovë".

Ju lutemi, vini re:

Bartësit gjerman të sigurimit pensional nuk kanë asnjë ndikim mbi shqyrtimin në Kosovë ose mbi vendimin që merret atje.

Vendbanim në Kosovë





Nëse ju banoni në Kosovë, atëherë ju e paraqisni, ju lutemi, kërkesën për pensionin kosovar tek autoriteti kompetent në Kosovë dhe shënoni që keni realizuar edhe përvojat e sigurimit në Gjermani. Autoriteti kosovar pastaj do t' i njoftojë Sigurimeve Gjermane të Pensioneve të gjitha të dhënat e nevojshme për vendimmarrjen mbi të drejtën për pension gjerman.

Të dy bartësit e sigurimit pensional vendosin pavarësisht njëri-tjetrit mbi të drejtën e pensionit sipas dispozitave të tyre kombëtare ligjore dhe ju njoftojnë me shkrim për këtë vendim.

Llogaritja e pensionit

Shuma e pensionit gjerman varet nga kontributet, të cilat keni paguar gjatë viteve. Që të jeni në gjendje ta kuptoni më lehtë vendimin mbi pensionin tuaj, ne jua shpjegojmë llogaritjen e pensionit në këtë kapitull.

Pensioni gjerman llogaritet nga katër faktorë, të cilët shumfishohen me njëri-tjetrin:

-  pikat e shpërblimit,
-  faktori i fillimit,
-  faktori i llojit të pensionit,
-  vlera aktuale e pensionit.

Vërejtje anësore: Informacione të tjera për llogaritjen e pensionit gjeni në broshurën "Rente: So wird sie berechnet".

Pikat e shpërblimit llogariten në bazë të të ardhurave tuaja vjetore bruto, të cilat pjesëtohen me të ardhurat mesatare të të gjithë të siguruarve. Nëse të ardhurat tuaja vjetore (për të cilat pagan kontribute për sigurimin pensional gjerman) për shembull gjatë vitit 2021 saktësisht 40 463 Euro, kështu ju për këtë vit merrni tamam një pikë shpërblimi, sepse të ardhurat mesatare kanë qenë kaq të larta. Në rast të të ardhurave më të larta ose më të ulëta pikat e shpërblimit janë përkatësisht më të larta ose më të ulëta. Në vartësi nga kohëzgjatja e punësimit tuaj në Gjermani dhe nga rroga juaj, rezulton kështu shuma e pikave tuaja të shpërblimit.

Faktori i fillimit e përmban uljen e pensionit, nëse ju e merrni pensionin para kohe (zbritja). Nëse e shfrytëzoni pensionin që nga kufiri i moshës së rregullt për të dalë në pension, atëherë faktori i fillimit është 1,0. Në rast të një pensioni të parakohshëm faktori i fillimit ulet përkatësisht me zbritjen.

Vërejtje anësore: Për zbritjen e pensionit, ju lutemi, lexoni faqen 23

Ju lutemi, vini re:

Nëse e shfrytëzoni pensionin vetëm pas kufirit të moshës së rregullt për të dalë në pension, ju e ngrini pensionin tuaj. Për çdo muaj kalendarik, në të cilin ju nuk e merrni pensionin pas arritjes së kufirit të moshës së rregullt për të dalë në pension, ju merrni një shtesë prej 0,5 %. Lexoni për këtë broshurën tonë „Die richtige Altersrente für Sie“.

Në faktorin e llojit të pensionit tregohet, për çfarë pensioni bëhet fjalë. Një pension pleqërie dhe pensioni i plotë i uljes së aftësisë për punë marrin një vlerë prej 1,0. Pensioni i pjesshëm i uljes së aftësisë për punë e merr vlerën 0,5, sepse bëhet fjalë për një gjysmë pension. Pensioni i madh i vejërisë ka një faktor pensioni prej 0,6 ose 0,55 (shih edhe faqen 35).

Shembull:

Nexhat T. ka fituar në Gjermani 20 pika shpërblimi. Ai dëshiron që nga 1 gusht 2023 të shfrytëzojë një pension pleqërie për të siguruarit prej shumë vitesh. Pensioni fillon atëherë një vit para plotësimit të kufirit të moshës për pension (12 muaj). Zbritja është pra, 3,6 për qind.

Pensioni i Nexhat T. llogaritet si më poshtë:

20 pika të shpërblimit

x 0,964 (faktori i fillimit me 3,6 për qind zbritje)

x 1,0 (faktori i llojit të pensionit për pensionin e pleqërisë)

x 37,60 Euro (vlera aktuale e pensionit që nga dt. 1 korrik 2023)

= 724,93 Euro

Vërejtje anësore: Vlerat aktuale i gjeni në internet nën www.deutsche-rentenversicherung.de.

Vlera aktuale e pensionit është vlera e vetme e formulës së pensionit, e cila do të ndryshohet nga fillimi i pensionit për shkak të ndryshimeve përshtatëse.

Ju lutemi, vini re:

Me sa dimë ne, për pensionet në Kosovë nuk bëhet asnjë llogaritje të pensioneve. Atje paguhet një lloj pensioni bazë.

Vërejtje anësore: Informacione më të hollësishme mësoni në kapitullin "Pensioni në Kosovë".

Pagesa e pensionit edhe jashtë vendit

Një shpërngulje mund të ndikojë mbi shumën e pensionit. Por marrëveshja rregullon parimisht që vendbanimi në Gjermani dhe në Kosovë janë të barabartë.

Nga këndvështrimi i Sigurimit Pensionsal Gjerman vlen: si shtetas i Gjermanisë ose i Kosovës ju e merrni pensionin gjerman, si rregull, në pothuajse të gjitha shtetet e botës. Pra, nuk luan asnjë rol, nëse ju si pensionist jetoni në Shqipëri, në Austri ose në Meksikë.

Megjithatë mund të ketë përjashtime nga ky rregull, nëse pensioni juaj përmban kohë, të cilat janë aprovuar sipas dispozitave të veçanta, për shembull sipas së drejtës gjermane për pensione në bazë të punës jashtë Gjermanisë.

Edhe në rast se ju keni një nënshtetësi tjetër, kjo mund të ketë ndikim në shumën e pensionit gjerman në rast të pagesës jashtë vendit.

Sugjerimi ynë:

Ju lutemi, informohuni tek sigurimi pensionsal gjerman përpara se të shpërnguleni në një vend tjetër. Sapo të planifikoni që të ndërtoni vendbanimin, ju lutemi, na njoftoni sa më shpejt që të jetë e mundur, adresën tuaj të re dhe lidhjen e re bankare. Kështu ndihmoni që pensioni juaj të mund të transferohet pa boshllëqe në vendin tuaj të ri.

Vërejtje anësore: Nëse ndryshohen adresa juaj ose lidhja bankare, ju mund ta njoftoni ose sigurimin pensionsal gjerman ose shërbimin e pensioneve. Adresat i gjeni që në faqen 53.

Pensionin gjerman është një përfitim ndërkombëtar. Ne e paguajmë pensionin tuaj në pothuajse të gjithë vendet e botës. Si rregull ju mund ta zgjidhni lirshëm institutin bankar, në llogarinë e të cilit ne e transferojmë pensionin. Të gjitha shpenzimet për transferimin në Kosovë mbahen nga ne; ju duhet të paguani vetëm shpenzimet e zakonshme të bankës suaj.

Vërejtje anësore: Pagesa e pensionit nuk duhet të bëhet patjetër në atë shtet, në të cilin banoni.

Sigurimi pensional gjerman është i detyruar që në rast të pagesave jashtë shtetit të kontrollojë në distanca të rregullta kohore, nëse kushtet për pagesën e pensionit vazhdojnë të ekzistojnë.

Prandaj ju merrni çdo vit një ftesë që të shënoni të gjitha të dhënat e nevojshme dhe ato konfirmohen (p.sh. me një të ashtuquajtur 'Certifikatë mbi jetën'). Kthejani këtë certifikatë mbi jetën, të nënshkruar dhe të vërtetuar sa më shpejt që të jetë e mundur ose përfitoni nga mundësia e re e futur e dëshmisë së jetës digjitale (D-LN). Me këtë ju kështu siguron që pensioni juaj të mund të paguhet rregullisht dhe pa vonesa.

Ju lutemi, vini re:

Pensioni sipas dispozitave të Kosovës paguhet - me sa dihet - vetëm, nëse ju banoni në Kosovë. Lexoni për këtë edhe sqarimet në kapitullin "Pensioni në Kosovë" që nga faqja 38.

Sigurimi shëndetësor dhe ai i përkujdesit tek pensionistët

Edhe pensionistë kanë nevojë për mbrojtje të sigurimit shëndetësor dhe duhet të paguhen eventualisht kontribute për sigurimin ligjor të përkujdesjes.

Sapo ju paraqisni një kërkesë për një pension gjerman, arka gjermane e sigurimit shëndetësor shqyrton, nëse ju jeni i siguruar sipas së drejtës gjermane dhe prandaj duhet të paguani nga pensioni juaj kontribute të detyrueshme për sigurimin shëndetësor gjerman. Nëse ju jeni të detyruar për t'u siguruar dhe jetoni në Gjermani, atëherë ju jeni po ashtu i detyruar të paguani kontribute për sigurimin e përkujdesjes sociale. Nga pensioni juaj mbahen atëherë kontributet për sigurimin gjerman shëndetësor dhe atë të përkujdesjes dhe i përcillen së bashku me pjesën e bartësit të sigurimit pensional gjerman arkës suaj të sigurimit shëndetësor.

Sugjerimi ynë:

Nëse ju jeni i siguruar vullnetarisht në sigurimin ligjor shëndetësor ose tek një kompanie private e sigurimeve, atëherë bartësi juaj i sigurimit pensional ju paguan eventualisht një shtesë për kontributin e sigurimit shëndetësor.

Vërejtje anësore: Informacione të tjera gjeni në broshurën "Rentner und ihre Krankenversicherung".

Nëse ju banoni në Kosovë, por merrni vetëm një pension gjerman, atëherë ju mund të jeni i siguruar edhe në Kosovë në sigurimin shëndetësor sipas së

drejtës gjermane, por jo në sigurimin e përkujdesjes. Atëherë ju keni të drejtë për përfitime materiale të sigurimit shëndetësor gjerman (për shembull trajtim mjekësor), të cilat mund t' i shfrytëzoni edhe jashtë Gjermanisë.




Vërejtje anësore: Mbi detyrimin për t' u siguruar në sigurimin shëndetësor gjerman dhe atë të përkujdesjes vendos vetëm arka gjermane e sigurimit shëndetësor.

Për informacione të mëtejshme për sigurimin shëndetësor gjerman drejtohuni, ju lutemi, arkës së shëndetësisë, tek e cila ju jeni siguruar aktualisht. Nëse tani për tani ju nuk jeni siguruar në sigurim shëndetësor në Gjermani, arka shëndetësore, tek e cila ju ishit siguruar së fundi, mund t' u përgjigjet pyetjeve tuaja.

Partnerët tuaj të kontaktit

Në këtë kapitull i gjeni adresat e bartësve të sigurimit pensional në Gjermani dhe në Kosovë si dhe të shërbimit të pensioneve.

Në Gjermani në raportin me Kosovën janë kompetentë bartësit e sigurimit si më poshtë:

-  Deutsche Rentenversicherung Bayern Süd,
-  Deutsche Rentenversicherung Bund dhe
-  Deutsche Rentenversicherung Knappschaft-Bahn-See.

Nëse kontributin tuaj të fundit gjerman ju ia keni paguar një bartësi rajonal (ish Institucionet e Sigurimeve të Landeve), partneri juaj i kontaktit është

Deutsche Rentenversicherung Bayern Süd,
Telefon 0871 81-0
Telefax 0871 81-2140
E-Mail service@drv-bayernsued.de
Internet www.deutsche-rentenversicherung-bayernsued.de.

Vërejtje anësore: Prefiksi për Gjermani është 0049

Pensionet e institucionit 'Deutsche Rentenversicherung Bayern Süd' jashtë vendit paguhen nëpërmjet:

Deutsche Post AG
Niederlassung Renten Service
13496 Berlin
Internet www.rentenservice.com

Nëse ju ia keni paguar kontributin tuaj të fundit gjerman institucionit 'Deutsche Rentenversicherung Bund' (ish Enti Federal i Sigurimeve për Nëpunësit), atëherë, ju lutemi, drejtohuni:

Deutsche Rentenversicherung Bund
Telefon 030 865-0
Telefax 030 865-27240
E-Mail meinefrage@drv-bund.de
Internet www.deutsche-rentenversicherung-bund.de

Nëse ju në ndonjë kohë keni paguar të paktën një kontribut gjerman institucionit 'Deutsche Rentenversicherung Knappschaft-Bahn-See (dikur Bundesknappschaft, Bahnversicherungsanstalt und Seekasse), partneri i kontaktit është:

Deutsche Rentenversicherung Knappschaft-Bahn-See
Telefon 0234 304-0
Telefax 0234 304-66050
E-Mail rentenversicherung@kbs.de
Internet www.kbs.de

Në Kosovë bartësi i mëposhtëm i sigurimit është i pranishëm për ju:

Departamenti i Pensioneve
Sheshi Miss Edit Durham nr. 46
10000 Prishtinë
Kosovë

„Vetëm një hap larg: Sigurimi juaj pensional“

A keni akoma pyetje? Ju keni nevojë për informacione ose dëshironi një këshillim individual? Ne jemi të gatshëm për ju: kompetent, neutral, falas.

Me broshurat tona informuese

Oferta jonë e broshurave ka një larmi të gjerë. Atë që ju intereson mundeni në www.deutsche-rentenversicherung.de ta shkarkoni ose porositni.

Këtu ne ju tërheqim vëmendjen për oferta të veçanta të këshillimit.

Në telefon

Pyetjeve tuaja ne u përgjigjemi në telefonin e shërbimit pa pagesë. Atje mund të porositni edhe material informacioni dhe formularë ose mund të pyesni për partnerin e përshtatshëm të kontaktit në vend. Ju na kontaktoni nën 0800 10004800.

Në Internet

Oferta jonë nën www.deutsche-rentenversicherung.de qëndron 24 orë në dispozicionin tuaj. Ju mund të informoheni mbi shumë tema dhe mund të shkarkoni ose porositni formularë dhe broshura. Me shërbimet tona online ju mund t' i kryeni të sigurt dhe nga shtëpia çështjet tuaja.

Me shërbimet tona online

Edhe përmes kompjuterit, tabletit ose smartphone-it mund të komunikoni me ne në mënyrë të sigurt. Ju mund të azhurnoni periudhat tuaja të sigurimit ose të paraqitni kërkesa online. Për t'u identifikuar, përdorni funksionin online të letërnjoftimit tuaj, kodin tuaj personal të hyrjes ose nënshkrimin tuaj të mëvonshëm.

Në bisedën personale

Qendrën më të afërt të informacionit dhe të këshillimit e gjeni në faqen bazë të internetit tonë ose ju interesoheni për këtë në telefonin e shërbimit. Atje mund të lidhni edhe rehatshëm një takim ose ju e prenotoni atë online. Në [telefon] mobil ju ndihmon aplikacioni ynë iRente.

Këshilltarët e sigurimeve dhe kujdestarët e sigurimeve

Edhe këshilltarët tanë dhe respektivisht kujdestarët për sigurime, të cilët veprojnë vullnetarisht, janë në fqinjësi direkte të gatshëm për ju dhe ju ndihmojnë për shembull gjatë plotësimit të formularëve të aplikimit.

Lidhja e shkurtër ndaj nesh

080010004800 (numër pa pagesë për Gjermani)

www.deutsche-rentenversicherung.de

info@deutsche-rentenversicherung.de

Këshillime shumëgjuhëshe ofrohen për fat të keq vetëm në ditë ndërkombëtare të këshillimit. Takimet i gjeni në internet.

Partnerët tanë

Në zyra të përbashkëta të shërbimit për rehabilitimin, ne ju këshillojmë së bashku me bartës të tjerë të shërbimeve në të gjitha çështjet rreth rehabilitimit.

Edhe tek seksionet e sigurimit të qyteteve dhe komunave ju mund të paraqisni kërkesat për pension, mund të merrni formularë ose mund të përcillni dokumentacionin e sigurimit.

Bartësit e sigurimit pensional gjerman.

Deutsche Rentenversicherung Baden-Württemberg	Gartenstraße 105 76135 Karlsruhe Telefon 0721 825-0
Deutsche Rentenversicherung Bayern Süd	Am Alten Viehmarkt 2 84028 Landshut Telefon 0871 81-0
Deutsche Rentenversicherung Berlin-Brandenburg	Bertha-von-Suttner-Straße 1 15236 Frankfurt/Oder Telefon 0335 551-0
Deutsche Rentenversicherung Braunschweig-Hannover	Lange Weihe 2 30880 Laatzen Telefon 0511 829-0
Deutsche Rentenversicherung Hessen	Städelstraße 28 60596 Frankfurt/Main Telefon 069 6052-0
Deutsche Rentenversicherung Mitteldeutschland	Georg-Schumann-Straße 146 04159 Leipzig Telefon 0341 550-55
Deutsche Rentenversicherung Nord	Ziegelstraße 150 23556 Lübeck Telefon 0451 485-0

Deutsche Rentenversicherung Nordbayern	Wittelsbacherring 11 95444 Bayreuth Telefon 0921 607-0
Deutsche Rentenversicherung Oldenburg-Bremen	Huntestraße 11 26135 Oldenburg Telefon 0441 927-0
Deutsche Rentenversicherung Rheinland	Königsallee 71 40215 Düsseldorf Telefon 0211 937-0
Deutsche Rentenversicherung Rheinland-Pfalz	Neugrabenweg 2-4 66123 Speyer Telefon 06232 17-0
Deutsche Rentenversicherung Saarland	Martin-Luther-Straße 2-4 66111 Saarbrücken Telefon 0681 3093-0
Deutsche Rentenversicherung Schwaben	Dieselstraße 9 86154 Augsburg Telefon 0821 500-0
Deutsche Rentenversicherung Westfalen	Gartenstraße 194 48147 Münster Telefon 0251 238-0
Deutsche Rentenversicherung Bund	Ruhrstraße 2 10709 Berlin Telefon 030 865-0
Deutsche Rentenversicherung Knappschaft-Bahn-See	Pieperstraße 14-28 44789 Bochum Telefon 0234 304-0

Impresum

Botuesi: Sigurimi i Pensionit Gjerman Federata
Sktori Marrdhënie me shtypin dhe publikun, komunikimi
10709 Berlin, Ruhrstraße 2
Adresa postare: 10704 Berlin
Telefon: 030 865-0, Telefax: 030 865-27379
Internet: www.deutsche-rentenversicherung.de
E-Mail: drv@drv-bund.de
Fotografi: Arshiva e fotografive Deutsche Rentenversicherung Bund
[Institucioni i Sigurimit Pensional në Gjermani - Federata]
Foto e titullit: fotolia.com ©
Shtypshkronja: Fa. H. Heenemann GmbH & Co., Berlin

Botimi i 4-të (7/2023), **nr. 775**.

Kjo broshurë është pjesë e marrëdhënieve publike të sigurimit pensional gjerman, ajo parimisht jepet falas dhe nuk është e destinuar për shitje.

Kodi QR është një markë e regjistruar e Denso Wave Incorporated.

Pensioni ligjor është dhe mbetet komponenti më i rëndësishëm për sigurimin e pleqërisë.

Partner kompetent në çështjet e përkujdesjes për pleqërinë është sigurimi pensional gjerman.

Ai kujdeset për më gati 57 milionë të siguruar dhe rreth 21 milionë pensionistë.

Kjo broshurë është pjesë e ofertës sonë të gjithanshme të këshillimit.

Ne informojmë.

Ne këshillojmë. Ne ndihmojmë.

Sigurim pensional gjerman.